

Kumtesë për media

ECMI Kosova denon ashpër shkatërrimin e varrezave ortodokse që ndodhën në mes të 20 dhe 21 janarit.

Varrezat ortodokse u shkatërruan gjatë incidenteve të ndryshme në Kllokot të komunes së Kllokotit, Plementin dhe Milloshevë në komunën e Obiliqit, Prelluzhë në komunën e Vushtrrisë, Syriganë në komunën e Skenderajt, dhe Prizren. Për më tepër, në kapellën ortodokse e cila gjindet në komunën e Milloshevës është vënë edhe zjarri.

Njëkohësisht, shtatorja e Luftës së Dytë Botërore e cila gjindej në qendër të Vitise dhe përkujtimorja e viktimave të intervenimit të NATO-s dhe të dy fëmijëve serb të vrarë në vitin 1999 në Gorazhdevc, janë shkatërruar në mes të ditës së diele dhe të hënës. Gjithashtu, policia dhe forcat e sigurisë nderkombetare kanë ndaluar një grupë protestuesish që tentonin të sulmonin manastirin në Gjakovë.

Këto incidente kanë ndodhur pas incidentit të ngjajshëm një muaj më heret, ku dhjetra varreza ortodokse në Fushë Kosovë ishin demoluar.

Si organizata jo-qeveritare e cila është e dedikuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve, ECMI Kosova mbështet krijimin e një shoqërie e cila e respekton dinjitetin njerezore, të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale të secilit qytetar të Republikës së Kosovës, duke përfshirë të drejtat të grupeve religjioze dhe etnike. Kosova ka bërë një rrugetim të gjatë dhe të mundimshme në pajtimin e komuniteteve etnike edhe integrimin e tyre në shoqërinë multi-etnike kosovare. Kosova duhet të vazhdojë të ndërtojë institucionet dhe shoqërinë bazuar në sundimin e ligjit dhe vlerave evropiane. ECMI Kosova bën thirrje të gjithë autoritetëve relevante që ti riparojnë shpejt varrezat e dëmtuara, dhe të sigurojnë që autorët të sillen para drejtësisë.

ECMI Kosova